



Informacione për vaksinimin kundër “Covid-19”

Më të rëndësishmet shkurtimisht

- **Të gjithë personave të rrezikuar në mënyrë të veçantë** nga mosha 16 vjeç ju këshillohet në vjeshtë/dimër vaksinimi kundër “Covid-19”. Këtu përfshihen:
 - Personat nga mosha 65 vjeç
 - Personat nga mosha 16 vjeç me një sëmundje kronike
 - Personat nga mosha 16 vjeç me trisomi 21
- Personat e rrezikuar në mënyrë të veçantë mund të përmirësojnë me vaksinimin mbrojtjen e tyre ndaj ecurive të rënda të sëmundjes për disa muaj.
- **Gratë shtatzëna**, pas sqarimit individual me mjeken ose mjekun e tyre, mund të marrin një vaksinim.

Pothuajse të gjithë personat kanë rënë tanimë në kontakt me virusin korona dhe sistemi i tyre i imunitetit është përballur përkatësisht me virusin. Variantet aktuale të virusit shkaktojnë ndaj personave pa faktorë rreziku më tepër ecuri më të buta sëmundjeje. Nëpërmjet rritjes së kontakteve në hapësirat e brendshme virusi korona mund të qarkullojë më shumë dhe probabiliteti i një sëmurjeje me “Covid-19” mund të rritet

Kujt i këshillohet një vaksinim në vjeshtë/dimër?

Të gjithë **personave të rrezikuar në mënyrë të veçantë** nga mosha 16 vjeç ju këshillohet në vjeshtë/dimër vaksinimi kundër “Covid-19”. Persona të rrezikuar në mënyrë të veçantë kanë një rrezik më të lartë për një ecuri të rëndë të sëmundjes dhe tek ata ulet më së pari mbrojtja e imunitetit. Vaksinimi përmirëson mbrojtjen kundër sëmundjeve të rënda dhe komplikimeve për disa muaj.

Cilët persona vlejné si të rrezikuar në mënyrë të veçantë?

- a) Personat nga mosha 65 vjeç
- b) Personat nga mosha 16 vjeç me forma të caktuara të sëmundjeve kronike të mëposhtme¹:
 - Hipertension/presion i lartë i gjakut
 - Sëmundje të sistemit kardiovaskular
 - Diabet
 - Sëmundje të mushkërisë dhe të rrugëve të frymëmarrjes
 - Kancer
 - Sëmundje dhe terapi, të cilat dobësojnë sistemin e imunitetit
 - Obeziteti (IMT \geq 35 kg/m²)
 - Insuficienca e veshkave
 - Cirroza e mëlçisë
- c) Persona nga mosha 16 vjeç me trisomi 21

Çfarë vlen për shtatzënat?

Gratë shtatzëna, pas sqarimit individual me mjeken ose mjekun e tyre, mund të marrin një vaksinim. Vaksinimi mund të jetë në raste individuale i dobishëm, sepse ai përmirëson mbrojtjen nga sëmundja e rëndë për disa muaj. Me variantet aktuale të virusit, rreziku i komplikimeve të shtatzënisë ose lindjes së parakohshme si rezultat i infeksionit është më i ulët se sa me variantet e mëparshme.

Çfarë vlen për grupet e tjera të popullsisë?

Të gjithë personave nën 65 vjeç pa faktorë rreziku nuk iu këshillohet një vaksinim në vjeshtë/dimër. Për ata vaksinimi sjell një mbrojtje të ulët dhe afatshkurtër kundër infeksioneve me sëmundje të lehta.

Po ashtu nuk ju rekomandohet një vaksinim as personave të kualifikuar shëndetësorë dhe personave të përkujdesjes. Megjithatë, ju mund të vaksinoheni, nëse ju, pas një peshimi dhe vendimi individual, dëshironi të zvogëloni rrezikun e një infeksioni me një sëmundje të lehtë.

Informacione për vaksinimin

Momenti i vaksinimit:

Momenti ideal për vaksinimin kundër “Covid-19” qëndron ndërmjet mesit të tetorit dhe mesit të dhjetorit. Ai mund të kryhen nga 6 muaj pas vaksinimit të fundit ose nga 6 muaj pas një infeksioni të njohur me virusin korona. Vaksinime të tjera me lëndë të tjera të çaktivizuara të vaksinimit (si p.sh. vakcina kundër gripit) mund të bëhen para, në të njëjtën kohë me një vaksinim kundër “Covid-19” ose pas kësaj.

Lëndë vaksinimi:

Lini që të vaksinoheni me një lëndë mRNA vaksinimi të përshtatur me variantin aktual të virusit ose me vaksinën e përshtatur të proteinës “Novavax”. Lidhur me këtë nuk luan asnjë rol, me cilat lëndë të vaksinave janë bërë vaksinimet e deritanishme.

E rëndësishme: Shtatzëna dhe gjdhënëse si dhe persona me sistem imuniteti të dobësuar rëndë do të duhej të linin të vaksinoheshin me një lëndë mRNA vaksinimi.

Alergjia: Nëse ju keni alergji të vërtetuara ndaj komponentëve të lëndës së vaksinimit, lini të këshilloheni nga një alergologe ose një alergolog.

¹ Listën e hollësishme të sëmundjeve e gjeni nën: *Kategoritë e personave të rrezikuar në mënyrë të veçantë*



Efektet anësore:

Në rast të çdo vaksinimi mund të ketë efekte anësore. Në shumicën e rasteve ato janë të dobëta deri në moderate dhe mbarojnë shpejt.

Në efektet më të shpeshta anësore bëjnë pjesë reaksione në vendin e injektimit si dhimbje, skuqje dhe ënjtje si dhe dhimbje koke dhe lodhje. Përveç kësaj mund të shfaqet dhimbje muskujsh dhe gjymtyrësh dhe simptoma të përgjithshme si të dridhura, ndjesi të temperaturës ose temperaturë.

Shumë rrallë ka efekte anësore serioze. Kështu për shembull tek persona të veçantë mund të ndodhë një reaksion alergjik i rëndë menjëherë pas vaksinimit. Ai shfaqet nëpërmjet një ënjtje të rëndë, skuqje, me kruajtje ose vështirësi frymëmarrjeje. Në raste shumë të rralla u vunë re brenda 14 ditëve pas vaksinimit infeksione të muskulit të zemrës ose perikardit që zakonisht ishin të lehta dhe mund të trajtoheshin mirë. Simptoma tipike të një infeksioni të muskulit të zemrës janë dhimbje gjoksi, vështirësi në frymëmarrje dhe aritmi e fortë, në pjesën më të madhe të kohës brenda 2 javësh pas vaksinimit.

Mund të shfaqen efekte të tjera anësore. Simptomat mund të jenë me kohëzgjatje të ndryshme. Ju lutemi, ia raportoni simptomat serioze ose të papritura pas vaksinimit kundër "Covid-19" një mjekjeje, një mjeku, një farmacistjeje, një farmacisti ose vendit të vaksinimit.

Probleme shëndetësore mund të shfaqen në çdo kohë, ndonjëherë edhe direkt pas një vaksinimi. Kjo nuk do të thotë se ato duhet të jenë një pasojë e vaksinimit.

Kostot:

Një vaksinimi i këshilluar është falas dhe mbulohet nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm për

- personat e rrezikuar në mënyrë të veçantë;
- shtatzënat pas sqarimit individual nëpërmjet mjekes ose mjekut.

Si mund të mbrohet secili si shtesë?

Ju mund të zvogëloni rrezikun e infektimit me virusin korona duke marrë masa të tjera, p.sh., duke mbajtur një maskë në ambiente të mbyllura.

Orientohuni për këtë në faqja e internetit «[Kështu mbrohem ne](#)».

Informacione të mëtejshme

Linja e informimit për virusin korona: +41 58 463 00 00

→ [Si funksionon vaksinimi kundër "Covid-19"?](#)

→ [Pyetjet e bëra shpesh \(FAQ\) \(admin.ch\)](#)